| 61 | Nimetazepam pluhur | Standart me formule C16H13N3O3 | 20 mg | 1 | Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së. |
| 62 | Pregabaline-d6 | 100 µg/mL in methanol, ampule of 1 mL | ampule | 1 | Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së. |
| 63 | Potassium Dichromate | me pasterti ≥99.8%, formula $K_2Cr_2O_7$ | gram | 500 | Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së. |
| 64 | EMIT II Plus Benzodiazepines në urinë ose ekuivalent | 29 mL / 12 mL | Kit | 2 | Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së. |
| 65 | EMIT II Plus Cocaine Metabolite në urinë ose ekuivalent | 28 mL / 12 mL | Kit | 2 | Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së. |
| 66 | EMIT II Plus Amphetamine në urinë ose ekuivalent | 29 mL / 12 mL | Kit | 2 | Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së. |
| 67 | EMIT II Plus 6 AM Assay në urinë ose ekuivalent | 28 mL / 14 mL | Kit | 2 | Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së. |
| 68 | EMIT II Plus Cannabionoids(THC) në urinë ose ekuivalent | 29 mL / 12 mL | Kit | 2 | Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së. |
| 69 | EMIT II Plus Ecstasy në urinë ose ekuivalent | 28 mL / 14 mL | Kit | 2 | Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së. |
| 70 | Sodium hypochlorite Solution | 14% | litër | 2 | Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së. |
| 71 | Sample cups per cuvette rotor (Siemens) ose ekuivalent | 2 ml | x1000 | 1 | Deri në 31.12.2023 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | *sipas kërkesave të IML-së.* |
| *72* | *Cuvette rotor set (Siemens) ose ekuivalent* | *set me 3* | *Set* | *1* | *Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së.* |
| *73* | *Kyveta per EIA Siemens ose ekuivalent* | *5 ml* | *x500* | *1* | *Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së.* |
| *74* | *Emit Calibrator/Control Level 0 ose ekuivalent* | *1x14 ml* | *cope* | *1* | *Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së.* |
| *75* | *Emit Calibrator/Control Level 1 ose ekuivalent* | *1x14 ml* | *cope* | *1* | *Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së.* |
| *76* | *Emit Calibrator/Control Level 2 ose ekuivalent* | *1x14 ml* | *cope* | *1* | *Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së.* |
| *77* | *Emit Calibrator/Control Level 3 ose ekuivalent* | *1x14 ml* | *cope* | *1* | *Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së.* |
| *78* | *Emit Calibrator/Control Level 4 ose ekuivalent* | *1x14 ml* | *cope* | *1* | *Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së.* |
| *79* | *Emit Calibrator/Control Level 5 ose ekuivalent* | *1x14 ml* | *cope* | *1* | *Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së.* |
| *80* | *Emit II Plus 6-AM/Ecstasy Calibrator/Control Level 1 ose ekuivalent* | *1x10 ml* | *cope* | *1* | *Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së.* |
| *81* | *Emit II Plus 6-AM/Ecstasy Calibrator/Control Level 2 ose ekuivalent* | *1x10 ml* | *cope* | *1* | *Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së.* |
| *82* | *Emit II Plus 6-AM/Ecstasy Calibrator/Control Level 3 ose ekuivalent* | *1x10 ml* | *cope* | *1* | *Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave* |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | të IML-së. |
| 83 | Emit II Plus 6-AM/Ecstasy Calibrator/Control Level 4 ose ekuivalent | 1x10 ml | cope | 1 | Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së. |
| 84 | Control Negative në urinë | 6x5 ml (1 kuti) | kuti | 1 | Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së. |
| 85 | Control Positive në urinë | 6x5 ml (1 kuti) | kuti | 1 | Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së. |
| 86 | Tuba OD 13 mm | Qelq, lartesia 120-130 mm | copë | 1000 | Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së. |
| 87 | Tuba OD 16 mm | Qelq, lartesia 100 mm | copë | 1000 | Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së. |
| 88 | Reagent syringe 1000ul | Gjatësia e gjilpërës 57 mm | copë | 1 | Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së. |
| 89 | Sample syringe 100ul | 5 CM 0,63 MM | copë | 1 | Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së. |
| 90 | Serum anti -A 10 ml | A-11H5 | cope | 5 | Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së. |
| 91 | Serum anti -B 10 ml | B-6F9 | cope | 5 | Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së. |
| 92 | Serum anti -D 10 ml | BS225 | cope | 3 | Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së. |
| 93 | Serum anti -C 5 ml | MS-24, P3X25513G8 | cope | 1 | Deri në 31.12.2023 sipas |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | kërkesave të IML-së. |
| 94 | Serum anti -c 5 ml | MS-33 | cope | 1 | Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së. |
| 95 | Serum anti -E 5 ml | MS-258, 906 | cope | 1 | Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së. |
| 96 | Serum anti -e 5 ml | MS-16, MS-21, MS-63 | cope | 1 | Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së. |
| 97 | Serum anti -M 2 ml | LM110, 140 | cope | 1 | Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së. |
| 98 | Serum anti -N 2 ml | N-20H12,MN879 | cope | 1 | Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së. |
| 99 | Serum albumin humane | 22% 10ml | cope | 2 | Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së. |
| 100 | ABA Card TM hematrace Kit ose ekuivalent | per gjurme gjaku njeriu | cope | 50 | Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së. |
| 101 | Test per sperm humane (RSID field kit for human semen ) ose ekuivalente | test i shpejte, pergjigjia afersisht 10 minuta | cope | 25 | Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së. |
| 102 | Kastle-mayer Blood test (K161) ose ekuivalent | test kimik per percaktimin e njollave te gjakut | kite | 2 | Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së. |
| 103 | Peroksid hidrogjeni | 33% | ml | 250 | Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së. |
| 104 | Sperm HY-LITER TM kitsfor ekstracts and Smears ose ekuivalent | Per te ngjyrosus 50 gropeza | cope | 1 | Deri në 31.12.2023 sipas |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | *kërkesave të IML-së.* |
| *105* | *Havan porcelani* | *jo me pak se 150 ml* | *cope* | *1* | *Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së.* |
| *106* | *Kuti mbajtese per lamat* | *( deri ne 100 vende)* | *cope* | *4* | *Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së.* |
| *107* | *Pipeta plastike* | *3 ml, pasteur* | *cope* | *1000* | *Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së.* |
| *108* | *Shirit ngjites sigurie per mbylljen e qeseve te provave* | *me permasa afersisht 4cm x 33 m* | *cope* | *1* | *Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së.* |
| *109* | *Mikropipete elektronike* | *Me nje kanal, (10-100μl), m saktesi 0.1 μL* | *cope* | *1* | *Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së.* |
| *110* | *Maja plastike per mikropipeta (10-100μl)* | *Te verdha* | *cope* | *500* | *Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së.* |
| *111* | *Thika mikrotomi** | *Profil I ulet* | *kuti* | *45* | *Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së.* |
| *112** | *Kaseta per derdhjen e copave ne blloqe plastike 24x24x6* | *me permasa afersisht 24x24x6* | *cope* | *50* | *Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së.* |
| *113** | *Laps per shkrim ne xham me maje diamanti* | *me permase 145- 152 mm* | *cope* | *2* | *Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së.* |
| *114* | *Beker 600 ml* | *Qelq borosilikat zjarrduruese* | *cope* | *3* | *Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së.* |
| *115* | *Llampe per alkol 100 ml+suport dhe rrjete* | *Llampa qelq, suport celik I kromuar dhe rrjete ne qender qeramike* | *cope* | *1* | *Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave* |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | të IML-së. |
| 116 | Markues laboratori | Ngjyre e zeze, rezistente ndaj solventeve e pershtatshme per kaseta dhe lama | cope | 10 | Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së. |
| 117 | Marker laboratori | Ngjyre e kuqe, rezistente ndaj solventeve e pershtatshme per kaseta dhe lama, maje e holle | cope | 10 | Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së. |
| 118 | Marker laboratori | Ngjyre e zeze, rezistente ndaj solventeve e pershtatshme per kaseta dhe lama maje e holle | cope | 10 | Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së. |
| 119 | Furca | furce e vogel forme peneli per pastim | cope | 12 | Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së. |
| 120 | Furca | Numer 2 | cope | 10 | Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së. |
| 121 | Furca | Per pastrim mikrotomi, numer 8 | cope | 12 | Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së. |
| 122 | Furca | Numer 0 | cope | 10 | Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së. |
| 123 | Vaj per mikrotom | shishe 50 ml | flakon | 4 | Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së. |
| 124 | Banjo termostatike | Përmasat: jo me pak se 330x95 mm (øxh) te jete ne forme rethore, per histologji | cope | 1 | Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së. |
| 125 | Formaline | me perqendrim 36% | liter | 200 | Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së. |
| 126 | alkool 96* | reagent I paster per histologji | liter | 20 | Deri në 31.12.2023 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | *sipas kërkesave të IML-së.* |
| *127** | *Balsam Canadez** | *Per histologji dhe citologji, 500 ml* | *cope* | *5* | *Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së.* |
| *128** | *Eozine e pergatitur** | *Eozinë 0,5% në tretësirë alkoolike* | *liter* | *12* | *Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së.* |
| *129** | *Hematoksiline* | *Harris* | *lter* | *10* | *Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së.* |
| *130* | *Doreza medium nitrili* | *Trashesia jo me shume se 0.25-0.30 mm* | *Kuti x100* | *250* | *Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së.* |
| *131* | *Doreza small nitrili* | *Trashesia jo me shume se 0.25-0.30 mm* | *Kuti x100* | *100* | *Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së.* |
| *132* | *Doreza Large nitrili* | *Trashesia jo me shume se 0.25-0.30 mm* | *kutix100* | *200* | *Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së.* |
| *133* | *Leukoplast* | *me permasa 87x58 mm* | *kuti* | *20* | *Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së.* |
| *134* | *Perparese nje perdorimshme* | *Polietilene* | *cope* | *5000* | *Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së.* |
| *135* | *Kapuc kirurgjikal nje perdorimsh* | *material polipropilen* | *cope* | *3000* | *Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së.* |
| *136* | *Garze 1 meter* | *sterile* | *cope* | *50* | *Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së.* |
| *137* | *Maska kirurgjikale* | *3 PLY* | *cope* | *500* | *Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave* |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | *të IML-së.* |
| *138* | *Mengore plasmasi* | *Polietilene, afersisht 400 mm* | *cope* | *1000* | *Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së.* |
| *139* | *Kostum pune per sallen e autopsise* | *Material doku* | *pale* | *25* | *Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së.* |
| *140* | *Maja bisturie* | *nr.24* | *cope* | *3000* | *Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së.* |
| *141* | *Gjilpere me nje vrime* | *jo me pak se 145 mm, per autopsi* | *cope* | *100* | *Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së.* |
| *142* | *Pinca hemostatike* | *me bisht te gjate, jo me pak se 18 cm* | *cope* | *4* | *Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së.* |
| *143* | *Bishta bisturie te medhenj* | *per bisturite me nr.24* | *cope* | *10* | *Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së.* |
| *144* | *Gershere per brinje* | *22 cm* | *cope* | *4* | *Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së.* |
| *145* | *Pinca te medha per kapjen e indeve ose organeve* | *16 cm* | *cope* | *4* | *Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së.* |
| *146* | *Luge e madhe per pastrimin e kavitetit nga gjaku* | *jo me pak se 100 cc* | *cope* | *2* | *Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së.* |
| *147* | *Meter per matjen e se kufomave* | *2-2.5 m* | *cope* | *2* | *Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së.* |
| *148* | *Vizore metalike* | *40-50 cm* | *cope* | *3* | *Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së.* |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| *149* | *Pe profesional per qepje per biopsi* | *Ngjyre bezhe ose blu* | *bobina* | *24* | *Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së.* |
| *150** | *Gershere me maje te holle* | *19-20 cm* | *cope* | *5* | *Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së.* |
| *151* | *Gershere me maje te harkuar* | *14-16 cm* | *cope* | *5* | *Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së.* |
| *152* | *Gershere te gjate per prerjen e organeve* | *20-22 cm maje rrumbullake* | *cope* | *5* | *Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së.* |
| *153* | *Cante autopsie* | *Seti permban :<br>Sharre autopsie jo me pak se 30 cm<br>cekic jo me pak se 23 cm<br>dalte afersisht 13 cm<br>thika autopsie17,17.5 dhe 25 cm<br>gjilpera per autopsi jo me pak se 12 cm<br>grepa per muskuj<br>tubula afersisht 23 cm<br>pincete anatomike jo me pak se 12<br>gershere 14 -15 cm* | *cope* | *10* | *Deri në 31.12.2023 sipas kërkesave të IML-së.* |

**Afatet e lëvrimit: do të bëhet në varësi të kërkesave dhe nevojave të Institucionit deri në 31.12.2023**

III.2.3. Neni 2 "Qëllimi i ligjit" 162/2020 "*Për prokurimin publik*" parashikohet se: "*Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

Neni 3 "Parime të përgjithshme" 162/2020 "*Për prokurimin publik*" parashikohet se: "*1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të*

*padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

Neni 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” 162/2020 “*Për prokurimin publik”* parashikohet se: “*1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

Në nenin 77 te ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

*a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*

*b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*

*c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.*

*Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*

*3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

*Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivit dhe pasivit.*

*Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*

*Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.*

*Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të*

*njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*
*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*
*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*
*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*
*5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.*

III.2.4. Neni 40, pika 3, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar, parashikon shprehimisht se :

*"Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve."*

Në nenin 40 pika 6 germa a) të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:
*6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*
*a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial 38 tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;*

III.2.5. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në përcaktimin apo vendosjen e kritereve specifike, që në thelb konsiderohen si kritere fituese, për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë se përcaktimi i këtyre kritereve duhet të jetë: *(i) në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese,*

*natyrën dhe vlerën e kontratës (ii) Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.* Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kritereve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi. Autoriteti kontraktues është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret për kualifikim, mjafton që ato të mos jenë diskriminuese e përjashtuese.

III.2.6. Referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues të paraqitura në ankesë, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në faktin nëse kërkesa për paraqitjen e mostrave për secilin prej artikujvetë markuar me shenjën "*", është në proporcion me objektin e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 77 pika 1 të LPP-së. Në rastin konkret KPP konstaton, se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertuese zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës. KPP konstaton, se për përmbushjen e këtij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm kritere kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e kapacitetit teknik, por edhe kritere të tjera kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e plotësimit të specifikimeve teknike të produktit me anë të dorëzimit të mostrave, konkretisht *"për të gjithë artikujt e ofruar të paraqiten katalogje ose skeda teknike të prodhuesit, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull".* Në këto kushte, KPP gjykon, se kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktor mbi dorëzimin e mostrave, është në përputhje me nenin 40, pika 6 gërma "a" të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar, por kërkesa për dorëzimin e mostrave për të gjithë artikujt e kërkuar në shtojcën 6 të dokumenteve të tenderit "formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit' të mallit të markuar me shenjën "*", është një kërkesë e ekzagjeruar dhe shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit. Komisioni gjykon, se është e mjaftueshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të paraqesin vetëm nga një ekzemplar (mostër) për produktet që do të prokurohen, me përdorim më të lartë për institucionin, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të tyre me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe që nuk ka mënyrë tjetër për t'i verifikuar ato, pavarësisht kërkesës për paraqitje të katalogut ose skedës teknike të prodhuesit ku përfshihen specifikime të hollësishme për artikullin e kërkuar. Për këtë arsye, autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin e dokumenteve të tenderit sipas konstatimeve të mësipërme.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3.1 Lidhur me pretendimet e mesiperme të operatorit ekonomik “Almedical” SHPK , Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në rastin konkret ndodhemi para kërkimit për sqarime mbi specifikimet teknike të artikujve të procedurës së prokurimit.

*Se dyti, ne shtojcen 5 te DST tek FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE autoriteti kontraktor ka perdorur disa ngjyra ne artikujt e kerkuar duke krijuar konfuzion tek operatori ekonomik se cila eshte arsyeja qe jane perdorur keto markime. Disa nga artikujt e markuar nga AK jane si me poshte:*

| ***Nr*** | ***Emertimi*** | ***Specifikime teknike*** | ***Njesia*** |
|---|---|---|---|
| *5* | *Kapak alumini dhe gomina per flakonet e qelqit 10 ml* | *kapak alumini, magnetik, gomina Silikone/PTFE, te pershtateshme per GCMS* | *cope* |
| *6* | *Flakon qelqi 10 ml per GC* | *OD x lartesia 22.5 x 46 mm fund rrumbullaket* | *cope* |
| *111* | *Thika mikrotomi** | *Profil I ulet* | *kuti* |
| *126* | *alkool 96** | *reagent I paster per histologji* | *liter* |
| *145* | *Pinca te medha per kapjen e indeve ose organeve* | *16 cm* | *cope* |

*1. Perse jane markuar me ngjyre lejla numrat 5 edhe 6?*
*2. Numri 145 perse eshte markuar ne ngjyre portokalli ne emertimin e tij?*
*3. Tek numri 111 dhe 126 eshte vendosur shenja e asteriksit tek emertimi dhe jo tek numri, a kerkohet edhe per keto artikuj mostra?*
*KERKOJME NGA <u>AK QARTESIMIN</u> E MARKIMEVE NE LISTEN E DST*

*Se treti, <u>kerkojme sqarime</u> me te detajuar te disa artikujve, te cilet nuk jane te qarte ne pershkrimin e tyre*

| | | | |
|---|---|---|---|
| *15** | *Insert liner for GC-MS vial 1,5ml* | *5.7x29.0 mm* | *cope* |
| *61* | *Nimetazepam pluhur* | *Standart me formule C16H13N3O3* | *20 mg* |
| *130* | *Doreza medium nitrili* | *Trashesia jo me shume se 0.25-0.30 mm* | *Kuti x100* |
| *131* | *Doreza small nitrili* | *Trashesia jo me shume se 0.25-0.30 mm* | *Kuti x100* |
| *132* | *Doreza Large nitrili* | *Trashesia jo me shume se 0.25-0.30 mm* | *kutix100* |

*Tek numri 15, Insert liner for GC-MS vial 1,5ml; KERKOJME SAKTESIMIN E VOLUMIT QE DUHET TE KETE INSERTI, pasi furnitori yne kete artikull e ka me volum 0.1 ml.*

*Per numrin 61, artikulli i kerkuar nuk eshte gjetur tek furnitoret si Standart. KERKOJME REFERENCE PER KETE PRODUKT per te orientuar operatorin ekonomik per te gjetur dhe ekuivalentin. Ky artikull ka formule te njejte me Mebendazole duke krijuar konfuzion tek operatori ekonomik, se cfare artikulli duhet te prezantoje.*

*Per numrat 130, 131, 132 eshte kerkuar trashesia jo me shume se 0.25 deri 0.30 mm. Ky specifikim krijon konfuzion sepse trashesia ëjo me shumeí nenkupton ëderi tek nje trashesi e caktuarí, nderkohe ne pershkrimin e artikujve eshte vendosur nje interval 0.25-0.30 mm, duke e bere te paqarte per operatorin ekonomik se cila duhet te jete trashesia e duhur per keto artikuj. Pra, a duhet qe trashesia te jete ne intervalin 0.25-0.30 mm, apo duhet te jete jo me shume se 0.30 mm, duke pranuar edhe trashesi me te vogel se 0.25mm.*

*KERKOJME NGA AK HEQJEN E SPECIFIKIMIT TE TRASHESISE SE DOREZAVE*

*Gjithashtu tek disa artikuj eshte kerkuar qe te jene te markes SIEMENS ose ekuivalent*

| | | |
|---|---|---|
| *71* | *Sample cups per cuvette rotor (Siemens) ose ekuivalent* | *2 ml* |
| *72* | *Cuvette rotor set (Siemens) ose ekuivalent* | *set me 3* |
| *73* | *Kyveta per EIA Siemens ose ekuivalent* | *5 ml* |

*Keto produkte nuk jane te detajuar ne pershkrimin teknik te tyre. Prandaj, per te gjetur produktet qe jane ekuivalente kerkojme nga AK SAKTESIME MBI PERSHKRIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE TE DETAJUARA PER KETO ARTIKUJ si gjatesia, gjeresia, diametri, dhe cdo lloj informacioni tjeter qe i nevojitet operatorit ekonomik per te prezantuar produktin e sakte qe AK kerkon.*

Në rastin konkret, Komisioni gjykon, se objekti i ankesës së operatorit ekonomik ankimues nuk lidhet me kundërshtimin e një vendimi të shprehur nga ana e autoritetit kontraktor (verifikim ligjor apo specifikim teknik në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik), por në thelb janë paqartësi mbi specifikimet teknike te artikujve të sipërcituara. Gjithashtu, KPP-ja konstaton, se autoriteti kontraktor, ka dhënë një përgjigje në lidhje më ankesën e operatorit ekonomik ankimues, në kundërshtim me nenin 75 të LPP-së i cili parashikon shprehimisht se: "*Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkese për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave.*
*Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit.".* Pra AK ka dhënë sqarime për operatorin ekonomik ankimues, lidhur me kërkesat e tij për sqarim. Gjithashtu, Komisioni sjell në vëmendje, se këto sqarime duhet të publikohen në përputhje me përcaktimet e nenit 75 të LPP-së.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomikë ankimues qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *"Për Prokurimin Publik"*, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",* e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, "*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*", Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*", nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *"Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19",* Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

**Vendosi**

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik "*Almedical*" SHPK për procedurën e prokurimit *"Procedurë e Hapur",* me Nr. REF-77296-08-11-2023, me objekt *"Blerje reagente dhe materiale laboratorike"* me fond limit: 13,205,500 Lekë pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 01.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Instituti i Mjekësisë Ligjore.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "Almedical" SHPK për procedurën e prokurimit *"Procedurë e Hapur",* me Nr. REF-77296-08-11-2023, me objekt *"Blerje reagente dhe materiale laboratorike"* me fond limit: 13,205,500 Lekë pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 01.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Instituti i Mjekësisë Ligjore.
3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues "Almedical" SHPK.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

| Nënkryetar | Anëtar | Anëtar |
|---|---|---|
| **Fiorent Zguro** | **Kreshnik Ternova** | **Anila Malaj** |

**Kryetar**

**Jonaid Myzyri**

Digitally signed by Jonaid MYZYRI Date: 2023.09.04 06:56:09

Vulosur elektronikisht nga Komisioni i Prokurimit Publik
Date:2023/09/04 18:37:59 +02'00'
9559572023090418375270020



*Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Komisioni i Prokurimit Publik)*